



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 453/prot.

Elbasan, më 7. 4.2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr. 30 dt.26.03.2025 “Për caktim agjenti tatimor për vitin 2025”, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Ilir BEJTJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHË
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Datë.28.03.2025

Nr.1765 prot

Nr.30 dt.26.03.2025

“PËR CAKTIM AGJENTI TATIMOR PËR VITIN 2025”

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 date 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit 9632 datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar me Ligjin nr.106/2017, datë 30.11.2017, VKM Nr. 132, date 07.03.2018" Për Metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të Pasurisë së Paluajtshme "Ndërtesa" e bazës së taksës për kategori specifike", VKB Nr.100, date 27.11.2024 "Për Miratimin e taksave dhe tarifave Vendore për vitin 2025" Këshilli Bashkiak I mbledhur sot me date 26.03.2025 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

V E N D O S I:

1. Të miratojë Agjent Tatimor Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sh.a. Elbasan, për vjeljen e Taksave dhe të Tarifave Vendore (tarifës së pastrimit, taksës së ndërtesës, tarifës së gjelbërimit, tarifës së ndricimit, tarifa të tjera) të abonentëve familjare për vitin 2025.
2. Masa e shpërblimit të agentit tatimor do të jetë 1 % e vlerës së arkëtuar.
3. Vjelja e detyrimit të pasqyrohet në faturën tatimore, detyrimi për çdo familje do të përpjestohet në muaj sipas marrëveshjes që do të lidhet me Shoqërinë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime.
4. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Bashkia Librazhd.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpallje.

SEKRETAR I KËSHILLIT
Elson MALLUTA

KRYETARI I KËSHILLIT
Mitat BIÇAKU





7/Vendim
Nº 5



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
DREJTORIA ETE ARDHURAVE VENDORE

PROJEKT - V E N D I M

Nr ____ Datë ____ / ____ 2025

“PËR CAKTIM AGJENTI TATIMOR PËR VITIN 2025”

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 date 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit 9632 datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar me Ligjin nr.106/2017, datë 30.11.2017, VKM Nr. 132 , date 07.03.2018" Për Metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të Pasurisë së Paluajtshme "Ndërtesa " e bazës së taksës për kategori specifike", VKB Nr.100, date 27.11.2024 “ Për Miratimin e taksave dhe tarifave Vendore për vitin 2025” me propozim të Kryetarit të Bashkisë ,Këshilli Bashkiak i mbledhur sot më datë ____/____/2025.

V E N D O S I:

- 1- Të miratojë Agjent Tatimor Shoqërinë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Sh.a. Elbasan, për vjeljen e Taksave dhe të Tarifave Vendore (tarifës së pastrimit, taksës së ndërtesës, tarifës së gjelbërimit, tarifës së ndricimit, tarifa të tjera) të abonentëve familjare për vitin 2025.
- 2- Masa e shpërblimit të agjentit tatimor do të jetë 1 % e vlerës së arkëtuar.
- 3- Vjelja e detyrimit të pasqyrohet në faturën tatimore, detyrimi për çdo familje do të përpjestohet në muaj sipas marreveshjes që do të lidhet me Shoqërinë Rajonale të Ujësjiellës Kanalizime .
- 4- Ndjek zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e të Ardhurave Vendore ,Bashkia Librazhd .
- 5- Ky urdhër hyn në fuqi mbas 10 ditësh nga dalja e Vendimit të Këshillit Bashkiak.

KRYETARI I BASHKISË

Mariglen Disha



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA LIBRAZHD
DREJTORIA E TE ARDHURAVE VENDORE

RELACION

**“ PËR
CAKTIMIN E AGJENTIT TATIMOR PËR TAKSA E TARIFA VENDORE PËR
VITIN 2025”**

Të nderuar Këshilltarë :

Mbështetur në Ligjin Nr. 139 /2015, datë 17.02.2015 “ Për Vetë qeverisjen Vendore “ i ndryshuar si dhe Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006, ” Për Sistemin e Taksave Vendore”,i ndryshuar, ,Ligjit Nr.9920 , datë 19.05.2008 ” Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqiperisë”, Ligjit Nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” ,si dhe në zbatim të VKB Nr .100, datë 27.11.2024 “ Paketa Fiskale 2025 “ kërkojmë që të miratohet Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Sh.a. Elbasan si Agjent Tatimor për vjeljen e taksave dhe të tarifave vendore për vitin 2025 si një mundësi shumë e mirë për vjelen e detyrimeve familjare.

Vjelja e taksave dhe tarifave do të shtrihet në disa muaj sipas marrëveshjes që do të lidhet midis Bashkisë dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Sh.a. Elbasan .

Masa e shpërblimit si agjent tatimor do të jetë 1 % e vlerës së arkëtuar .

Sa më lart kërkojmë që të miratohet projekt- vendimi për vjeljen e taksave dhe tarifave vendore të familjarëve për vitin 2025.

Ju faleminderit !

DREJTORE E TE ARDHURAVE VENDORE

Lindita Shuli